



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 29, datë 29.08.2019

“Mbi përdorimin e aseteve të teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e informacionit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 3, pika 3, të nenit 44, pika 1, shkronja “c”, të nenit 52, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 6, pika 7, të nenit 17, pika 1, dhe pika 4, shkronjat “a”, “b”, “g” dhe “h” të Rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.25, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi përdorimin e aseteve të teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e informacionit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha njësitë organizative të Agjencisë.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar